



REPUBLICA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE

URDHER

Nr. 136 Date 26.02.2008

PER

PRISHJEN E SHOQERISE "TREGTIMI I LIBRIT ARTISTIK DHE
SHKENCOR" SH.A TIRANE DHE SHPALLJEN E SAJ NE LIKUIDIM

Ne mbështetje te nenit 102, pika 4 e Kushtetutës se Republikës se Shqipërisë; nenit 1 te Ligjit nr. 8885, date 22.04.2002, për disa ndryshime ne Ligjin nr. 7926, date 20.04.1995, "Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore ne Shoqëri Tregtare", ndryshuar me akte te tjera ligjore; Ligjin nr. 7638, date 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare", për shkak te situatës se rende ekonomiko-financiare, humbjen e objektit kryesor te punës, me cilësinë e zotëruesit te 100% te aksioneve ne shoqërinë "Tregtimi i librit artistik dhe shkencor" Sh.a Tirane,

URDHEROJ:

1. Prishjen e shoqërisë "Tregtimi i librit artistik dhe shkencor" Sh.a Tirane dhe shpalljen e saj ne likuidim e regjistruar si person juridik me Vendimin nr. 33556 date 16.05.2005 te Gjykatës se Rrethit Tirane.
2. Caktimin si likuidator te shoqërisë Z. Ardian Tafili me profesion Inxhinier Ndërtimi.
3. Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë do te përbëhet nga:
 - Anila Tanku
 - Nuri Sopaj
 - Hasan Metuku
4. Te hartohet dokumentacioni ne përputhje me dispozitat e Seksionit te V te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".
5. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Juridike ne METE për kryerjen e veprimeve përkatëse ne përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit"

Ky urdhër hyn ne fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE

URDHER

Nr. 154 Date 26.02 2009

PER

EMËRIM LIKUIDATORI NE SHOQERINE

“TREGTIMI I LIBRIT ARTISTIK DHE SHKENCOR” SH.A. NE LIKUIDIM

TIRANE

Ne mbështetje te nenit 102, pika 4 e Kushtetutës se Republikës se Shqipërisë; nenit 1 te Ligjit nr. 8885, date 22.04.2002, Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, pasi mora ne konsiderate dorëheqjen e likuidatorit Z. Ardian Tafili,

URDHEROJ :

1. Emërimin ne detyrën e likuidatorit te shoqërisë Z. Rezart Ferzaj me page mujore 72,000 (shtatëdhjetë e dy mije leke).
2. Procedurat e likuidimit te ndiqen ne zbatim te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”.
3. Ngarkohet shoqëria “Tregtimi i Librit artistik dhe shkencor” sh.a. ne likuidim, për kryerjen e veprimeve përkatëse ne përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit”

Ky urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

MINISTRI

GENCRULI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PRONES PUBLIKE

Nr. 147, Prot.

URDHER

Nr. 746 Date 08-09 2009

PER

EMERIM LIKUIDATORI

Mbështetur ne Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ne Ligjin nr. 7926, date 20.04.1995, "Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore ne Shoqëri Tregtare", i ndryshuar, me cilesine e aksionerit te vetem dhe te asamblese se shoqerise:

URDHEROJ :

1. Lirimin nga detyra te likuidatorit te shoqerise "Tregtimi i Librit Artistik dhe Shkencor",
- Z. Rezart Ferzaj
2. Shkeputja e mardhenieje financiare te behet bazuar ne legjislacionin ne fuqi
3. Emërohet ne detyren e likuidatorit te shoqerise "Tregtimi i Librit Artistik dhe Shkencor" Tirane;
- Z. Alfred Ndrio
4. Mardheniet financiare fillojne me paraqitjen e tij ne detyre.
5. Ngarkohet Drejtoria e Shoqerise per kryerjen e veprimeve perkatese ne perputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9723, date 03.05.2007, "Për Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëhere.

MINISTRI

GENC RULI





REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SUPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHEME E PRONËS SHITËTORE
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3
Nr. 7819/ Prot.

Tel: ++355 ...; Fax: ++355 4 251 388
Tiranë, më 9/12/2015

Drejtuar: "TREGTIMIT TË LIBRIT ARTISTIK DHE SHKENCOR" SHA NË
LIKUIDIM, RRUGA "KAVAJËS", NR. 16 ✓

QËNDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT

Tiranë

Tiranë

Subjekti: Miratojmë bilancin e mbylljes së shoqërisë "Tregtimi i Librit Artistik dhe Shkencor" SHA në likuidim

Në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", dhe të raportit përfundimtar të hartuar nga ekspertja kontabël e autorizuar, miratojmë:

Bilancin përfundimtar të mbylljes së shoqërisë "Tregtimi i Librit Artistik dhe Shkencor" SHA në likuidim.

Në përputhje të seksionit V, të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të bëhet çregjistrimi i shoqërisë, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

ARBEN AHMETAJ



R A P O R T

PER AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE PERFUNDIMTARE

TE SHOQERISE

“ *TREGETIMI I LIBRIT ARTISTIK DHE SHKENCOR* ”

sh.a ne likujdim

TIRANE

PERIUDHA USHTRIMORE

01/01/2015-30/09/2015

PERMBAJTJA

	Faqe
• Raporti i Audituesit te Pavarur	1-4
• Raporti I likuidatorit	1-2
• Urdherat nr.577 date 25/01/2014, nr.578 date 25/01/2014 1069/1 date 19/02/2014, nr. 2359/1 date 05/11/2014, nr.483 date 05/11/2014, nr.2509/1 date 23/04/2015, nr.2509/2 date 17/06/2015, nr. 2509/4 date 28/07/2015 te Ministrit te Zhvillimit Ekonomik, Tregtise dhe Sipermarrrjes.	
• Pasqyrat financiare te vitit 2014	
• Pasqyrat financiare / perfundimtare ne date 30/09/2015	



RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR PER LIKUIDIMIN E SHOQERISE

Ministrise se Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtise dhe Siper marrjes

Aksionerit te Vetem te Shoqerise "Tregtimi I Librit Artistik dhe Shkencor" sh.a ne likuidim

Ne kemi audituar pasqyrat financiare perfundimtare bashkalidhur te shoqerise "Tregtimi I Librit Artistik dhe Shkencor" sh.a ne likuidim , te cilat perfshijne pasqyren e pozicionit financiar te dates 30/09/2015, pasqyren e te ardhurave gjithepershires, pasqyren e ndryshimeve ne kapital dhe pasqyren e flukseve te parase per periudhen e perfunduar ne kete date dhe informacionin tjeter shpjegues.

Theksojme se nga ana e drejtimit jane hartuar pasqyrat financiare per vitin 2014 per efekt te deklarimit dhe raportimin e tyre prane organeve tatimore, nderkohe jane hartuar pasqyrat per periudhen 01 janar deri me 30 shtator 2015, te cilat jane perfundimtare per aksionerin e kesaj shoqerie, me qellim vendimarrjen per perfundimin e likuidimit te shoqerise.

Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare

Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit dhe te Raportimit Financiar dhe per ato kontrole te brendshme, qe drejtimi e konsideron te nevojshme per te bere te mundur pergatitjen e pasqyrave financiare qe nuk permbajne anomali materiale, per shkak te mashtrimit apo gabimit.

Pergjegjesia e Audituesit

Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare bazuar ne auditimin e kryer nga ana jone. Ne e kryem auditimin ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto Standarte kerkojne qe ne te respektojme kerkesat etike dhe te planifikojme dhe kryejme auditimin per te arritur sigurine e arsyeshme se pasqyrat financiare nuk permbajne anomali materiale .

Me Vendimin nr.136 date 26/02/2008 te Ministrit te Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes eshte urdheruar: Prishja e shoqerise "Tregtimi i librit artistik dhe shkencor" sha Tirane dhe shpallja e saj ne likuidim.

Shoqeria ka vazhduar me kete status per disa vite dhe me Urdherin nr.37 date 29/10/2013 eshte vendosur: Fillimi i procedurave per mbylljen e te gjitha veprimeve te shoqerise ne likuidim. Nga ana e shoqerise jane hartuar dhe paraqitur pasqyrat financiare deri ne date 10/03/2014 per gjendjen e shoqerise, ku eshte konstatuar nga auditimi se shoqeria nuk ploteson kushtet per likuidim pasi eshte me detyrime te pa shlyera.

Shkresa nr.1069/2 date 19/02/2014 e Ministrit te Zhvillimit Ekonomik, Tregtise dhe Siper marrjes urdheron veprimet e mbylljes si me poshte:

- Ne zbatim te nenit 514,526 te kreut IV, te Kodit Civil "Shuarja e detyrimeve" te behet kalimi i detyrimeve kreditore dhe debitore ne rezultatin e shoqerise
- Pajisjet e zyrave te kalojne ne administrim te "Shperndarja e Librit Shkollor" sh.a ne likuidim dhe te kryhen veprimet perkatese sipas ligjit 9228, date 29/04/2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar

Ne zbatim te shkrese se mesiperme ne pasqyrat financiare te vitit 2014 kane kaluar ne rezultat veprimet e meposhteme:

Kalim ne shpenzime:

- Kerkesa te arketueshme per 5,364,468 leke (kliente te vjeter)
- Tvsh kreditore per shumen 313,608 leke (ne sistem tatimor tvsh kreditore eshte 347,874 leke)
- Kerkesa ndaj punonjeseve per deme te shkaktuara per 2,081,113 leke
- Kerkesa te arketueshme te pa detajuara per 209,844 leke
- Kerkesen ndaj shtypshkronjes "Naim Frashri" kalime fondi per shumen 2,300,290 leke
- Parapagime ne shumen 34,698 leke
- **Totali ne shpenzime 10,304,021 leke**

Rimarrje ne te ardhura

- Detyrime ndaj furnitoreve te vjeter per 910,568 leke
- Provizione afatgjata per shumen 2,081,113 leke
- **Totali ne te ardhura per 2,991,681 leke.**

Me urdherin nr.577 date 25/01/2014 te Ministrit te Zhvillimit Ekonomik, Tregtise dhe Siper marrjes eshte bere zvogelimi i kapitalit per objektin "Magazine e Re tek Qyteti i Nxenesve" kati i pare duke ja kaluar ne administrim shoqerise "Shperndarja e Librit Shkollor" sha ne likuidim.

Nga ndryshimi i i kapitalit jane:

- Pakesuar zeri ndertesa per shumen 24,528,000 leke
- Zvogeluar kapitali i regjistruar i shoqerise per 1,099,000 leke
- Zvogeluar zeri rezerva rivlersimi per shumen 23,428,090 leke
- Zvogeluar rezerva te tjera per shumen 910 leke.

Shoqeria ne date 31/12/2014 rezulton me detyrime te pa shlyera ne shumen 3,910,144 leke nga te cilat:

- Detyrime ndaj pagave te punonjesve per 1,052,612 leke
- Detyrime ndaj sigurimeve shoqerore per 545,879 leke
- Detyrime per TAP ne shumen 65,520 leke
- Detyrime ndaj dy personave per paradhenien e ankandit ne shumen 986,828 leke
- Detyrime ndaj buxhetit te shtetit ne shumen 1,259,305 leke
- **Totali i detyrimeve ne date 31/12/2014 eshte 3,910,144 leke**



Ne aktiv shoqeria ne date 31/12/2014 ka pasqyruar :

- Vleren e aktiveve afatgjata (kioska dhe pajisje zyre) ne shumen 1,337,106 leke
- Inventar ne magazine ne shumen 15,750 leke
- Aktive monetare ne shumen 3,157.65 leke

Totali i aktivitet 1,356,013.65 leke

Me shkresen nr. 2359/1 date 05/11/2014 te Ministrit te Zhvillimit Ekonomik, Tregtise dhe Sipermerrijes eshte vendosur per kalim ne rezultat i vleres se kioskave ne shumen 1,119,000 leke si dhe rimarrjen ne te ardhura te detyrimit ndaj buxhetit te shtetit ne shumen 1,259,305 leke.

Shoqeria kete urdher nuk e ka pasqyruar ne pasqyrat financiare te vitit 2014.

Veprimet e siperpermendura ne urdher, kalim ne shpenzime (vleren e kioskave) per shumen 1,119,000 leke dhe rimarrjen ne te ardhura te detyrimit ndaj buxhetit te shtetit per qerane ne shumen 1,259,305 leke i ka raportuar ne pasqyrat e mbylljes ne date 30/09/2015.

Me shkresen nr. 483 date 05/11/2014 te Ministrit te Zhvillimit Ekonomik, Tregtise dhe Sipermerrijes eshte miratuar kalimi i fondit per shlyerjen e detyrimeve ne shumen 2,913,752 leke. Ky fond ka kaluar ne llogarine e shoqerise ne date 27/03/2015 ne shumen 2,913,752 leke.

Fondi i kaluar eshte shpenzuar si me poshte:

Nr	Emertimi	Detyrime te mbartura nga 2014	Detyrime te krijuarane vitin 2015	Totali I likuidimeve
1	Furnitore I krijuar ne 2015(hartimi I PF)		48,000	48,000
2	Paga te punonjesve	962,145	609,884	1,572,029
3	Keshilli mbikqyres	62,263		62,263
4	Sigurimet shoqerore dhe shendetsores	531,949	229,932	761,881
5	Tatim ne burim per KM		10,988	10,988
6	Komisione bankare		11,961	11,961
7	Taksat vendore		44,240	44,240
8	Ineteresa dhe gjoba	187,557		187,557
Totali I pagesave		1,743,914	955,005	2,698,919

Totali i likuidimeve eshte 2,698,919 leke.

- Gjendja e likujditeteve ne date 01/01/2015 eshte 3,157.65 leke
- Fonde te marra ne date 27/03/2015 mne shumen 2,913,752 leke
- Interesa nga banka 396.66 leke
- **Totali i likujditetve 2,917,306.31 leke**
- Shpenzuar gjate 2015 ne shumen 2,698,919 leke
- **Diferenca e ngelur per 218,397.31 leke i kane kaluar ne llogarine e MZHETTS shuma 218,425 leke ne date 02/10/2015 kthim fondi.**

Inventari ekonomik eshte dorezuar te "Shperndarja e Librit Shkollor" sh.a ne likuidim sipas urdherave.

Diferenca te vogla ne paga dhe sigurime jane rimarre ne te ardhura.

Ne lidhje me likuidimin shprehim rezerven ne lidhje me ceshtjet si me poshte:

1-Shoqeria per shitjen e nje objekti, i cili aktualisht i ka kaluar "Shperndarjes se Librit Shkollor" sha ne likuidim, ka mare paradhenie per zhvillimin e ankandit, ku dy personave aktualisht nuk u jane kthyer shumat e depozituara , si me poshte:

• Shkelqim Tanushi	490,560 leke
• Athanas Xhavara	490,560 leke
• Totali	981,120 leke

Shumat nuk jane kthyer pasi nga ana e likuidatorit pretendohet se ka qene e pa mundur te kontaktoje me personat.

Nga ana e tyre prane shoqerise nuk eshte paraqitur asnje pretendim per kthimin e shumave deri ne kete date te hartimit te raportit.

Vlera per 981,120 leke eshte rimarre ne te ardhura ne pasqyrat financiare te mbyllura ne date 30/09/2015.

2-Ne sistemin tatimor prane Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane, shoqeria ne daten e hartimit te raportit eshte debitore ne shumen 30,000 leke, per mos paraqitje ne afat te vendimit te aksionerit per miratimin e pasqyrave financiare.

Theksojme se nga likuidatori jane kthyer fondet gjendje ne kete date ne llogarine e MZHETTS.

Shoqeria nuk mund te crregjistrohet pa likuiduar detyrimin prane Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane.

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare te hartuara ne 30/09/2015 te shoqerise "Tregtimi i Librit Artistik dhe Shkencor" sha ne likuidim Tirane , me perjashtim te ceshtjeve (1-2) te trajtuara me siper jane pergatitur, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi per likuidimin e shoqerise.

Eksperthe Kontabel e Regjistruar
ANITA PULAJ
 ANITA PULAJ
Ekspert kontabel te
autorizuar
License Nr. 155

Tirane me 14/10/2015

BLV. Gjergj Fishta, Pall G& P, hyrja II, Kati II, mbi Credins Bank, Tirane
Tirane, Nr. Kontakti Cel.0692087743 , e-mail pulaj_anita@yahoo.com

Tirane me __02/10/2015

RAPORTIN E MBYLLJES SE SHOQERISE

Ministrise se Zhvillimit Ekonomik, Tregtise dhe Siper marrjes

Aksionerit te vetem te Shoqerise "Tregtimi i Librit Artistik dhe Shkencor" sh.a, ne Likuidim

Ne baze te shkreses te Ministris se Zhvillimit Ekonomik, Tregtise dhe Siper marrjes nr. 1069/2, date 19/02/2014, Mbi veprimet e mbylljes se shoqerise "Tregtimi i Librit Artistik dhe Shkencor" sha

Ne daten 10.03.2014 shoqeria jone hartoi bilancin e mbylljes se shoqerise, por per munges fondesh per te likuiduar detyrimet e saj nuk u arrit te mbyllej.

Fondet e kerkuara nga ana e shoqeris jane levruar ne muajin Prill te vitit 2015, menjehere me levrimin e tyre filluam proceduren e shbllokimit te llogarise bankare te bllokuara nga Drejtoria e tatim taksave per mos pagesat e detyrimeve. E njejta procedure eshte zhvilluar edhe per Bashkine Tirane per detyrimet endaj tyre.

Shoqeria per kalimin ne likuidim, ne aktivin e saj kishte:

Aktive afatgjata kioska me vlere 1,119,080.00 leke

Aktive afatgjata materiale me vlere 218,026.00 leke

Ne pasivin e saj ishin pasqyruar detyrimet e meposhtme:

- Detyrime ndaj punonjesve dhe detyrime per sigurime shoqerore, shendetesore, tap per shumen 1,664,011.00 leke
- Detyrime ndaj pjesemarrjesve ne ankand per shumen 986,828.00 leke
- Detyrime qeraje ndaj buxhetit te shtetit per shumen 1,259,305.00 leke

Gjate procesit te likuidimit per te gjitha problemet qe kemi hasur kemi kerkuar MZHETS per trajtimin e ceshtjeve te mesiperme.

Me shkresen nr.1609/2, date 19/02/2014 te MZHETS eshte bere kryerja aktit te marrjes ne dorezim te inventrit nga ana e Shoqerise "Shperndarja e Librit Shkollor" sha ne likuidim e siper

Me shkresen nr. 2359/1, date 05/11/2014 te Ministris te MZHETS kemi kaluar ne rezultat financiar vleren e kioskave si edhe detyrimin kreditor per qerate.

Per detyrimet e pjesemarrjesve ne ankand kemi hasur ne veshtiresi per gjetjen e personave, sipas ligjit dhe procedurave te mbylljes se shoqeris kemi shperndare dy here shpalljen :

“Ftese per Kreditorët” prane Qendres Kombetare te Regjistrimit. Pasi nuk na rezultoi asnje pretendim nga kreditorët, e kemi kaluar ne rezultatin financiar dhe kete detyrim.

Per te gjitha problemet kemi derguar shkrese Drejtorise se Privatizimit prane Ministrise se Zhvillimit Ekonomik, Tregtise dhe Siper marrjes.

Shuma 218,425.00 lek qe ngelet e pa perdorur i kthehet Ministrise se Zhvillimit Ekonomik Tregtise dhe e Siper marrjes.

Bilanci perfundimtar shoqerise ne date 02/10/2015 paraqitet me gjendjen zero.

Pas perfundimit te procedurave ligjore per likuidimin e shoqerise dhe shperndarjen e aktiveve ju njoftoj perfundimin e likuidimit dhe kerkoj cregjistrimin e shoqeris ne perputhje me seksionin V te ligjit 9723 date 3/05/2007 “per Qendren Kombetare te Regjistrimit”

Bashkengjitur me kete raport eshte dhe bilanci i likuidimit date 30/09/2015

Ju faleminderit per bashkepunimin.

LIKUIDATORI





REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3

Tel: ++355 ...; Fax: ++355 4 251 388

Nr. 1069/4 Prot.

Tiranë, më 19/2/2014

Drejtuar: "TREGTIMI I LIBRIT ARTISTIK DHE SHKENCOR" SHA NË
LIKUIDIM,
RRUGA "KAVAJES", NR. 16

Tiranë

Subjekti: Mbi veprimet e mbylljes së shoqërisë

Në zbatim të nenit 198, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe në zbatim të Urdhrit 37, datë 29.10.2013 të Ministrit të Zhvillimit të Ekonomisë Tregtisë dhe Sipërmarrjes, "Për mbylljen e veprimeve të shoqërisë në likuidim "Tregtimi i Librit Artistik dhe Shkollor" sha nga ana juaj të kryhen veprimet e mëposhtme:

- Në zbatim të nenit 514, 526 të Kreut IV, të Kodit Civil " Shuarja e detyrimeve" të bëhet kalimi i detyrime kreditore dhe debitore në rezultatin e shoqërisë.
- Pajisjet e zyrave të kalojnë në administrim të "Shpërndarja e Librit Shkollor" sha në likuidim dhe të kryhen veprimet përkatëse në zbatim të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar.
- Brenda datës 25.02.2014 të paraqitet për miratim pranë MZHETS, raporti i likuiduesit për mbylljen e shoqërisë dhe bilanci i mbylljes së bashku me Miratimin e Këshillit Mbikëqyrës.
- Brenda datës 28.02.2014 të kryhen të gjitha veprimet e mbylljes së shoqërisë pranë QKR-së në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Për sa me sipër, merrni masat e nevojshme për respektimin e afateve në të kundërtën do të viheni para përgjegjësisë në bazë të akteve ligjore në fuqi.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

ARBEN AHMETAJ

MINISTRI



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3
Nr. 2359/, Prot.

Tel: ++355; Fax: ++355 4 251 388
Tiranë, më 6 / 11 / 2014

Drejtuar: "TREGTIMI I LIBRIT ARTISTIK DHE SHKENCOR" SHA NË
LIKUIDIM, RRUGA "KAVAJËS", NR. 16

Tiranë

Subjekti: Miratim për kalim në rezultat financiar.

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 11, datë 31.03.2014 dhe në zbatim të nenit 198, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 12.04.2014 miratojmë:

- Kalimin në rezultat financiar të vlerës së kioskave, për të cilat ka qenë e pamundur të realizohej identifikimi dhe gjetja e tyre.

Detyrimi kreditor për shumën 1.259,305 lekë është detyrim i trashëguar para kalimit të shoqërisë në likuidim, dhe së bashku me shumën për rimbursim të TVSH të trajtohen në zbatim të shkresës nr.1069/1, datë 19.02.2014 të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

ARBEN AHMETAJ





REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË
DHE SËPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT

URDHËR

Nr. 483 Datë 5.11.2014

Mbi shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë "Tregtimi i Librit Artistik dhe Shkencor" SHA në likuidim

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës së Shqipërisë, Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Ligjin Nr.7582, datë 13.07.1992 "Për Ndërmarrjet Shtetërore" dhe VKM-së nr.54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"

URDHËROJ:

1. Nga fondet e siguruara nga të ardhurat nga qiratë, të bëhet shlyerja e detyrimit ndaj shoqërisë "TLASH" në likuidim, për shumën 2,913,752 lekë (dy milion e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy)
2. Ngarkohet Drejtoria e Financës në MZHETS, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ARBEN AHMETAJ





REPUBLIKA E ALBANI
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE DIFËRMARJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHMË E PRONËS SHITËTORE
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3
Nr. 2509/1 Prot.

Tel: ++355 ...; Fax: ++355 4 251 388
Tiranë, më 23 / 4 / 2015

Drejtuar: "TREGTIMI I LIBRIT ARTISTIK DHE SHKENCOR" SHA NË
LIKUIDIM
RRUGA "KAVAJES", NR. 16 ✓

Tiranë

Subjekti: Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 14, datë 27.03.2015

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 141, datë 27.03.2015 ku kërkonte specialist kontabiliteti për përpilimin e pasqyrave financiare për vitin 2014 dhe ekspert kontabël për auditimin këtyre pasqyrave ju sqarojmë se:


Në zbatim të nenit 198, të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" nga shoqëria është dorëzuar bilanci përfundimtar i likuidimit dhe Raporti i Ekspertit të Autorizuar "Mbi auditimin e Pasqyrave Financiare për mbylljen e shoqërisë", e ngarkuar me Urdhrin nr.37, datë 29.10.2013 të Ministrit të MZHETS "Për mbylljen e veprimeve të shoqërisë në likuidim, "Tregtimi i Librit Artistik dhe Shkencor", në të cilën thekson **se shoqëria për shkak të mos shlyerjes së detyrimeve monetare nuk plotësohen kushtet për përfundimin e likuidimit**, në të cilën përfshihen; detyrimet për shlyerjen e kreditorëve për pjesëmarrje në ankand, detyrime për pagat dhe sigurimet shoqërore.

Në zbatim të nenit 200, të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" likuiduesi i paraqet asamblesë së përgjithshme, një raport për procedurën e likuidimit, për detyrimet e shlyera dhe për shpërblimin e tij.

Sa më lart, në bazë të raportit përmbledhës nga ana e MZHETTS ju është vënë në dispozicion fondi, i cili i ka hapur rrugë përfundimit të bilancit përfundimtar të likuidimit, i cili do të dorëzohet në QKR.

Nga ana juaj dhe ekspertes të emëruar me Urdhrin nr. 37, datë 29.10.2013 të Ministrit të MZHETTS "Për mbylljen e veprimeve të shoqërisë në likuidim "Tregtimi i Librit Artistik dhe Shkencor", duhet të merren masat për përfundimin e mbylljes së shoqërisë në një kohe sa më të shkurtër.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM


FREDERIK SEITI



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3
Nr. 2509/2 Prot.

Tel: ++355 ...; Fax: ++355 4 251 388
Tiranë, më 17/6/2015

Drejtuar: "TREGTIMI I LIBRIT ARTISTIK DHE SHKENCOR" SHA NË
LIKUIDIM
RRUGA "KAVAJES", NR. 16 ✓

Tiranë

Për dijëni: "SHPËRNDARJA E LIBRIT SHKOLLOR" SHA NË LIKUIDIM

Tiranë

NDËRMARRJA INDUSTRIALE NR 1

Tiranë

Subjekti: Mbi veprimet e mbylljes së shoqërisë

Në vijim të shkresës nr. 2509/1, datë 23.04.2015, nga ana e shoqërisë suaj nuk jemi informuar mbi veprimet që po kryhen për mbylljen e shoqërisë. Për këtë arsye, kërkojmë në mënyrë të menjëhershme kryerjen e veprimeve të mëposhtme:

- Në zbatim të shkresës 1069/1, datë 19.02.2014 ti bëhet dorëzimi i të gjithë pajisjeve dhe inventarit ekonomik shoqërisë "Shpërndarja e Librit Shkollor" SHA në likuidim.
- Zyrat ti dorëzohen Ndërmarrjes Industriale nr. 1 si administruesja e tyre.
- Të bëhet një raport përmbledhës mbi veprimet e kryera nga ana juaj, për mbylljen e shoqërisë dhe përdorimin e fondeve të vëna në dispozicion.
- Brenda datës 30.06.2015 të kryhen të gjitha veprimet e mbylljes së shoqërisë pranë QKR-së në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Për sa më sipër, merrni masat e nevojshme për respektimin e afateve, në të kundërtën do të viheni para përgjegjësisë në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

FREDERIK SEITI



SEKRETARI PËRGJITHSHËM



MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHMË E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3

Nr. 2509/4 Prot.

Tel: ++355 ...; Fax: ++355 4 251 388

Tiranë, më 28/7/2015

Drejtuar: "TREGTIMI I LIBRIT ARTISTIK DHE SHKENCOR" SHA NË
LIKUIDIM
RRUGA "KAVAJËS", NR. 16

Tiranë

Subjekti: Mbi veprimet e mbylljes së shoqërisë


Në vijim të shkresës nr. 2509/3, datë 03.07.2015 "Përgjigje e kërkesës për raportin e mbylljes së shoqërisë", nga ana juaj të përfundojnë procedurat e mbylljes së shoqërisë duke kaluar shumë e pa përdorur për llogari të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Merrni masa për mbylljen e shoqërisë dhe dorëzimin e një kopje të raportit përfundimtar së bashku me bilancin e mbylljes, brenda datës 28.07.2015, në MZHETTS për Drejtorinë e Privatizimit.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

FREDERIK SEITI

SEKRETARI PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT

Nr. 578 Prot.

Tiranë, më 25/1 /2014.

Drejtuar: "SHPËRNDARJA E LIBRIT SHKOLLOR", SHA NË LIKUIDIM,
RRUGA "KAVAJËS", NR. 16,
"TREGTIMI I LIBRIT ARTISTIK DHE SHKENCOR", SHA NË
LIKUIDIM, RRUGA "KAVAJËS", NR. 16,

TIRANË.

Lënda: Dërgim Urdhri.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për zbatim Urdhrin e Ministrit të MZHETS nr. 45, datë 22.01.2014, "Për kalimin në administrim të "Shpërndarja e Librit Shkollor" sha, në likuidim, Tiranë të objekteve në administrim të "Tregtimit të Librit Artistik dhe Shkencor" sha në likuidim".

Shoqëria "Shpërndarja e Librit Shkollor" sha, në likuidim në bashkëpunim me shoqërinë "Tregtimi i Librit Artistik dhe Shkencor" në likuidim të kryejë veprimet përkatëse në zbatim të legjislacionit në fuqi, për dorëzimin dhe marrjen e objekteve në administrim të saj.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHE E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT

URDHËR

Nr. 45, datë 22.01.2014

PËR

**KALIMIN NË ADMINISTRIM TË "SHPËRNDARJA E LIBRIT SHKOLLOR" SHA
NË LIKUIDIM, TIRANË TË OBJEKTEVE NË ADMINISTRIM TË "TREGTIMIT TË
LIBRIT ARTISTIK DHE SHKENCOR" SHA NË LIKUIDIM.**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në bazë të paragrafit të parë të nenit 2, të Ligjit Nr. 8237, datë 01.09.1997 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmartjeve shtetërore në shoqëri tregtare, (i ndryshuar), të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të Urdhërit të Ministrit të MZHETS Nr. 37, datë 29.10.2013,

URDHËROJ:

1. Objektet "Magazinë e Re tek Qyteti i Nxënësve", kati i parë, Tiranë, "Librari Artistike" Përmet, "Librari" Poliçan, "Librari" Pukë, "Librari nr.4" Fier të kalojnë në administrim të "SHPËRNDARJA E LIBRIT SHKOLLOR" sh.a. në likuidim, Tiranë.
2. Procedurat e privatizimit të objekteve të mësipërm do të ndiqen nga "SHPËRNDARJA E LIBRIT SHKOLLOR" sh.a. në likuidim, Tiranë.
3. Ngarkohet shoqëria "SHPËRNDARJA E LIBRIT SHKOLLOR" sh.a. në likuidim dhe "TREGTIMI I LIBRIT ARTISTIK DHE SHKENCOR" sha në likuidim, Tiranë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë .

MINISTRI

ARBEN AHMETAJ



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT

Nr. 577 Prot.

Tiranë, më 25/1 /2014.

Drejtuar: "TREGTIMI I LIBRIT ARTISTIK DHE SHKENCOR", SHA NË
LIKUIDIM, RRUGA "KAVAJËS", NR. 16,

TIRANË.

Lënda: Dërgim Urdhri.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për zbatim Urdhrin e Ministrit të MZHETS nr. 41, datë 20.01.2014, "Për zvogëlimin e kapitalit themeltar të sha në likuidim "Tregtimi i Librit Artistik dhe Shkencor".

Shoqëria "Tregtimi Librit Artistik dhe Shkencor" sha në likuidim të kryerje veprimet përkatëse në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT

URDHËR

Nr 41, datë 20/04 2014

PËR ZVOGËLIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TË SHA NË LIKUIDIM
“TREGTIMI I LIBRIT ARTISTIK DHE SHKENCOR”.

Bazuar në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve në shoqëri tregtare”, ndryshuar me akte të tjera ligjore dhe të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” me cilësinë e zotëruesit të 100% të aksioneve të shoqërisë “Tregtimi i Librit Artistik dhe Shkollor” në cilësinë e aksionarit të vetëm:

URDHËROJ:

1. Kapitali themeltar të zvogëlohet për vlerën 1,099,000 lekë e barabarte me 1,099 aksione me vlere nominal 1000 lekë secili.
2. Kapitali themeltar i sha “Tregtimi i Librit Artistik dhe Shkencor”, Tiranë në likuidim, të bëhet nga 16,700,000 lekë në 15,601,000 leke e barabartë me 15,601 aksione me vlere nominale 1000 lekë secili.
3. Ngarkohet likuidatori i shoqërisë, për kryerjen e veprimeve përkatëse në përputhje me parashikimet e Ligjit 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, seksioni III.
4. Ngarkohet shoqëria për zbatimin e këtij urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

